



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d), nenit 40, paragrafi 40.2, pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008), nenit 61, paragrafi 61.2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika b) dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2016, merr këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN 2017 DHE TË KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE PËR PËRIUDHËN 2017 - 2019

Neni 1

Miratohet Buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2017 dhe korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2017-2019.

Neni 2

Shuma e propozuar e buxhetit për vitin 2017, të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi është 62,023,630 €

Neni 3

Pjese përbërëse e këtij Vendimi është tabela e planit të buxhetit për vitin 2017 dhe korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2017-2019.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.nr. 400-245613, më 29.09.2016



KRYETARI I KUVENDIT
Helmi Halimi, jur. i dipl.